



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

466/20
21.08.20
Data/Datum.

PSH .nr.466/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenkovic - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Besa Security” SH.P.K. Prishtinë , kundër njoftimit për kontratë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe Montimi i kamerave në Institucionet Arsimore ”, me nr. të prok: 616-20-2907-1-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës” , më datën: 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Besa Security ” SH.P.K. Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe Montimi i kamerave në Institucionet Arsimore ”, me nr. të prok: 616-20-2907-1-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës”.

II.OBLIGOHET autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës, që të veprojë konform nenit 53.7 të LPP-së, nenit 25 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, dhe sipas rekomandimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe Montimi i kamerave në Institucionet Arsimore ”, me nr. të prok: 616-20-2907-1-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Besa Security ” SH.P.K. Prishtinë, SH.P.K. Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Besa Security ” SH.P.K. Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.07.2020 me nr. 466/ 20, kundër njoftimit për kontratë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe Montimi i kamerave në Institucionet Arsimore ” , me nr. të prok: 616-20-2907-1-2-1, të iniciuar nga, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “Kuvendi i Komunës së Prishtinës”,

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 ,9 ,dhe 27 të LPP-së si dhe nenin 18.16 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 03.08.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Besa Security ” SH.P.K. Prishtinë,

Pretendimi nr .1

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues se certifikata ISO IEC 20000-1 2011, nuk ka te beje me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit, nuk qëndron për faktin se certifikata në fjalë ka të bëjë pikërisht me teknologjinë informative, me te cilën edhe ka te bëjë natyra e këtij aktiviteti të prokurimit.

Sa i përket pretendimit apo arsyetimit te OE ankues, se ne kohe pandemie dhe për shkak te kohës se shkurtër nuk mund te pajisemi me këtë certifikate dhe njëherit pretendon se këtë certifikate nuk e posedojnë shume operatore ekonomik, andaj edhe kërkon largimin ne tërësi te kësaj certifikate.

Eksperti shqyrtues, vlerëson si te drejte këtë pretendim, dhe njëherit duke u bazuar ne shkresat e lendes nuk ka vërejtur se AK-ja, ka bere hulumtim te tregut për të vërtetuar faktin se a ka mjaftueshëm operatore ekonomik te pajisur me këtë certifikate.

Po ashtu është me rendësi të përmendet fakti që afati për dorëzim të ofertave ka qene i parapare 16.07.2020 dhe sipas dispozitave të nenit 25 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operative për Prokurim Publik, AK-ja është e obliguar të caktojë një datë tjetër për dorëzim të ofertave, prandaj, eksperti shqyrtues i rekomandon AK-se, që gjatë këtij afati të bejë hulumtim se a ka operatore ekonomik të pajisur me këtë lloj certifikate dhe në varësi të konstatimit, të vendos apo edhe ta heq në tërësi këtë kërkesë në mënyrë që të këtë pjesëmarrje me të madhe të operatoreve ekonomik, kjo për shkak se edhe gjendemi në situatë pandemie ku OE-te e kanë të pamundur që të sigurojnë në një afat shumë të shkurtër një certifikate ISO.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njëherit të obligohet AK-ja që të veprojë konform nenit 25 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operative për Prokurim Publik.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 03.08.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer fare përgjigje për ta njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 03.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 20.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër Njoftimit për Kontratë- në kritere të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se certifikata ISO IEC 20000-1 2011, nuk ka te beje me natyrën e këtij aktiviteti te prokurimit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk qëndron për faktin se certifikata në fjalë ka të bëjë pikërisht me teknologjinë informative, me te cilën edhe ka te bëjë natyra e këtij aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me pretendimin OE ankues, se ne kohe pandemie dhe për shkak te kohës se shkurtër nuk mund te pajise mi me këtë certifikate dhe njëherit pretendon se këtë certifikate nuk e posedojnë shume operatore ekonomik, andaj edhe kërkon largimin ne tërësi te kësaj certifikate.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues, vlerëson si te drejte këtë pretendim, dhe njëherit duke u bazuar ne shkresat e lendes nuk është vërejtur se AK-ja, ka bere hulumtim te tregut për të vërtetuar faktin se a ka mjaftueshëm operatore ekonomik te pajisur me këtë certifikate.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se po ashtu është me rendësi te përmendet fakti qe afati për dorëzim te ofertave ka qene i parapare 16.07.2020 dhe sipas dispozitave te nenit 25 te Rregullores dhe Udhëzuesit Operative për Prokurim Publik, AK-ja është e obliguar te caktojë një date tjetër për dorëzim te ofertave, prandaj, andaj AK-se, gjate këtij afati te beje hulumtim se a ka operatore ekonomik te pajisur me këtë lloj certifikate dhe ne varësi te konstatimit, te vendos apo edhe ta heq ne tërësi këtë kërkesë ne mënyrë qe te këtë pjesëmarrje me te madhe te operatoreve ekonomik, kjo për shkak se edhe gjendemi ne situatë pandemie ku OE-te e kanë te pamundur qe te sigurojnë ne një afat shume te shkurtër një certifikate ISO.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pa kënaqur me kërkesë padi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
- 1x1 OE - "Besa Security" SH.P.K. Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së


Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković